


Përshkrimi i kursit

Shumë menaxherë të shoqërive ujësjellës kanalizime sot përballen me sfiden e reduktimit të ujit pa të ardhura, ndërkohë që duhet të rrisin nivelin e shërbimit, zgjerojnë rrjetin shpërndarës për t'u përgjigjur rritjes së popullsisë, të financojnë zëvendësimin dhe mirëmbajtjen në kohë të aseteve ekzistuese, si dhe të trajtojnë ujin e ndotur.



Mënyra së si një shoqëri ujësjellës kanalizime menaxhon asetet përcakton suksesin në adresimin e këtyre sfidave.

Një shoqëri mund të përmirësojë nivelin e shërbimit, të zvogëlojë humbjet e ujit, të reduktojë kostot si dhe të justifikojë tarifat nëse e di se çfarë asetesh zotëron dhe çfarë asetesh i nevojiten, kur dhe si t'i mirëmbajë ose zëvendësojë ato, dhe si mund t'i operojë ato.

Ky kurs trajnimi trajton të gjithë elementët bazë për menaxhimin e aseteve me qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e menaxhimit të aktiveve.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs trajnimi mbi menaxhimin e aseteve i drejtohet të gjithë ofruesve të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Kursi është veçanërisht i vlefshëm dhe mund të ndiqet nga Drejtorët e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime, Kryeinxhinierët dhe Inxhinierët, Kryefinancierët dhe Menaxherët.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Njihni konceptin e menaxhimit të aseteve dhe elementët kryesor të tij;
- Kuptoni rëndësinë e menaxhimit të aseteve;
- Hartoni inventarin e aseteve të shoqërisë suaj;
- Përdorni sisteme të ndryshme renditje për të vlerësuar gjendjen e aseteve;
- Njihni çfarë është një sistem i menaxhimit të aseteve dhe qëllimet e tij;
- Përcaktoni nivelin e shërbimit që shoqëria duhet të sigurojë si dhe mënyrën më efikasë për ta ofruar atë;
- Përcaktoni asetet kritike si dhe të identifikoni kostot e mundshme të dëmtimit të tyre;
- Identifikoni procedurat e përshtatshme të operimit dhe mirëmbajtjes;
- Njiheni me konceptet e menaxhimit të kostove përgjatë gjithë ciklit të jetës së aseteve;
- Identifikoni burimet financiare për financimin e programit të menaxhimit të aseteve.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Menaxhimin e Aseteve. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB: 13,000 lekë për person.
Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.

FORMULAR REGJISTRIMI

Emër Mbimër _____

Datëlindja _____

Institucioni _____

Pozicioni _____

Edukimi _____

Celular _____

E-mail _____

Adresa _____

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit training@shukalb.al.
Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të Shoqatës si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

Banka: PROCREDIT, Dega Tiranë

Emri i Llogarisë: Shoqata e Ndërmarrjeve Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë

Numri i Llogarisë: 10-831379-00-01

IBAN: AL 95209111080000108313790001

***Shënim:** Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.*

Nëse ju konfirmoni dhe mungoni në këtë trajnim pa paparalajmëruar minimalisht 3 ditë përpara, atëherë shuma e plotë e pagesës do tju mbahet.